Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/491
Datë: 27.11.2020

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 28.10.2020 nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. **Riakreditohet** "Kolegji UBT" me adresë "Lagja Kalabria" p.n., Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën pesë (5) vjeçare, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1. **Administrator i sistemit dhe rrjetit kompjuterik,** Niveli V sipas KKK, me 122 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 31.01.2020 deri 31.01.2025. Kolegji UBT për këtë profil mund të realizojë procesin mësimor me 4 grupe në vit, ndërsa numri i kandidatëve për grup duhet të jetë 25.

2. **Zhvillues i aplikacioneve,** Niveli V sipas KKK, me 130 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 31.01.2020 deri 31.01.2025. Kolegji UBT për këtë profil mund të realizojë procesin mësimor me jo më shumë se 4 grupe në vit, ndërsa numri i kandidatëve për grup duhet të jetë 25.

3. **Asistent administrativ,** Niveli III sipas KKK, me 12 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 26.08.2019 deri 26.08.2024.Kolegji UBT për këtë profil mund të realizojë procesin mësimor me jo më shumë se 10 grupe në vit, ndërsa numri i kandidatëve për grup duhet të jetë 20.

II. **Akreditohet** "Kolegji UBT" me adresë "Lagja Kalabria" p.n., Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre vjeçare, përkatësisht nga data 28.10.2020 deri 28.10.2023, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve:

1. **Shitja dhe shërbimi i klientit,** Niveli III sipas KKK, me 12 kredi të AAP. Kolegji UBT për këtë profil mund të realizojë procesin mësimor me jo më shumë se 10 grupe në vit, ndërsa numri i kandidatëve për grup duhet të jetë 20.

2. **Instalues elektrik,** Niveli III sipas KKK, me 19 kredi të AAP. Kolegji UBT për këtë kualifikim mund të realizojë procesin mësimor me jo më shumë se 4 grupe në vit, ndërsa numri i kandidatëve për grup duhet të jetë 10.

3. **Gjuhë gjermane,** Kolegji UBT për këtë profil mund të realizojë procesin mësimor me jo më shumë se 20 grupe në vit, ndërsa numri i kandidatëve për grup duhet të jetë 15.

III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "Kolegji UBT" për riakreditim dhe akreditim, dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Rivalidimin e kualifikimit, si dhe Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Riakreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për Rivalidim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për Riakreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. "Kolegjit UBT";
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar i KD së AKK